VENDIM
Nr.243, datë 26.3.2004

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË MINISTRITË DHE INSTITUCIONET BUXHETORE PËR VITIN 2004 DHE PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 14 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve buxhetorë për vitin 2004, në ministritë dhe institucionet buxhetore, të jetë sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave të paraqesin, brenda muajit maj 2004 në Këshillin e Ministrave materialin për ristrukturimin e plotë të numrit të punonjësve në institucionet buxhetore.

3. Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, zëri "Paga dhe sigurime shoqërore", t'i shtohen 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, të cilat t'i pakësohen buxhetit të vitit 2004, zëri "Paga dhe sigurime shoqërore", miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve e Kullotave, për shkak të ndryshimit të numrit të përgjithshëm të punonjësve në këto dy institucione.

4. Ngarkohen ministrat dhe drejtuesit e institucioneve buxhetore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja 1. Numri i punonjesve buxhetore per vitin 2004

Ministria/Institucioni qendror	Nr.Punonjesve 01janar - 30prill	Nr.Punonjesve 01maj - 31dhjetor
Presidenca	66	66
Kuvendi	407	407
Keshilli i Ministrave	305	305
Ministria e Integrimit	72	72
Ministria e Industrise dhe Energjitikes	398	390
Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit	1,300	1,300
Ministria e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit	410	440
Ministria e Ekonomise	210	210
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	1,260	1,250
Regjistrimi i Pasurive te Paluajtshme	242	242
Ministria e Financave	455	455
Ministria e Arsimit dhe Shkences	44,300	44,000
Ministria e Kultures, Rinise e Sporteve	1,120	1,120
Ministria e Shendetesise	21,400	21,250
Ministria e Drejtesise	2,260	2,672
Ministria e Puneve te Jashtme	177	186
Ministria e Rendit Publik	13,745	13,468
Ministria e Mbrojtjes	9,000	9,000
Sherbimi Informativ Shteteror	1,400	1,400
Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	120	120
Drejtoria e Rezervave te Shtetit	300	285
Akademia e Shkencave	620	620
Kontrolli i Larte i Shtetit	150	150
Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale	1,397	1,405
Ministria e Mjedisit	100	100
Agjensia Kombetare e Privatizimit	55	55
Prokuroria e Pergjithshme	760	760
Pushteti Gjyqesor	1,140	1,140
Gjykata Kushtetuese	30	30
Agjensia Telegrafike Shqiptare	118	118
Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	2,165	2,165
Drejtoria e Pergjithshme e Doganave	1,050	1,050
Drejtoria e Pergjithshme e Standarteve	25	22
Drejtoria e Pergithshme e Pyjeve dhe Kullotave	1,050	1,020
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve	1,520	1,520
Instituti i Statistikes	155	155
Enti Kombetar i Zonave te Lira	7	7
Shkolla e Magjistratures	17	17
Qendra Kombetare e Kinematografise	10	10
Instituti i Integrimit te Ish-te perndjekurve politike	50	50
Keshilli i Larte i Drejtesise	34	34
Avokati i Popullit	45	45
Komisioni i Sherbimit Civil	28	28
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	60	60
Avokati i Shtetit	60	60
Inspektoriati i Larte i Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive	30	30
Autoriteti i Konkurrences	15	15
Totali	109,638	109,304